



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr.998/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit NSH KB “SH...”, përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit – Zyra Rajonale në Prishtinë, kundër të paditurit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia Kadastrale e Kosovës, për anulimin e aktvendimit 03/2348/18 të datës 26.07.2021 , jashtë seancës me datën 01.03.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, shpallet JO KOMPETENTE në pikëpamje lëndore në çështjen juridike me numër KA.nr.998/22, sipas padisë së paditësit NSH KB “SH...”, të datës 27.08.2021, kundër të paditurit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia Kadastrale e Kosovës, për anulimin e aktvendimit 03/2348/18 të datës 26.07.2021.
- II. Pas plotfuqishmërisë se këtij Aktvendimi lënda se bashku me shkresat e saj t’i dorëzohet Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Paditësi NSH KB “SH...” , përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit-Zyra Rajonale në Prishtinë,më datën 27.08.2021, ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, ndaj të paditurit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), për anulimin e aktvendimit 03/2348/18 të datës 26.07.2021.

Gjykata, ri gjykim dhe rivendosje të lëndës, gjatë shqyrtimit paraprak të padisë në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së dhe udhëzimeve nga gjykata e shkallës së dytë, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës

së Parë, Departamenti për Çështje Administrative nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Meqenëse në rastin konkret paditës në këtë çështje kontestimore është NSH KB “SH...” e cila është nën administrimin e AKP-së, gjykata iu referua Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili përcakton kompetencat ekskluzive të Dhomës së Posaçme lidhur me kërkesat e Agjencisë që pretendon të drejta pronësie apo posedimi në pasuritë në pronësi apo posedim të një personi fizik apo juridik.

Lidhur me këtë, neni 5 par. 7 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përcakton se: *“Asnjë gjykatë në Kosovë, përveç Dhomës së Posaçme, nuk do të ketë kompetencë apo autoritet mbi asnjë kërkesë, lëndë, procedurë apo rast të përshkruar me paragrafin 1 të këtij neni, përveç atyre që në mënyrë të veçantë përcaktohen në paragrafin 4 të këtij neni. ...”* dhe nenin 6 par.1, nën-par. 1.3. pika 1.3.1. të po të njëjtit ligj sipas të cilit përcaktohet se paditës në procedurën para Dhomës së Posaçme është: *“... 1.3. Agjencia, që pretendon të drejta pronësie apo posedimi apo interesa të tillë mbi apo në: 1.3.1. pasuritë në pronësi apo posedim të një personi fizik apo juridik, apo nën administrimin e autoritetit të saj personal”*. Andaj, në kuptim të dispozitave të cituara, gjykata gjeti se nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje juridike sepse kjo çështje bie në kompetencë ekskluzive të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Prandaj, bazuar në 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, nenin 26 par. 1, pika 1.6 të Ligjit për 06/L-054 për Gjykatat dhe nenin 17, 19, 29, 387 par. 1 pika (u) dhe nenit 392 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore lidhur me nenin 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr 998/22, datë 01.03.2023

Gjyqtari  
Arnis Dumani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.